

## Projekti "Fuqizim Ekonomik për Personat me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri"



Faqe 5

## Asistencë Ligjore për personat me aftësi të kufizuar



Faqe 7

## Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi



Faqe 9



## Monitorimi i Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara

Faqe 2



## Punësim për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara

Faqe 4



## Monitorimi i Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara

**N**ë Janar 2005, Qeveria Shqiptare miratoi një strategji kombëtare multi sektoriale (SKPAK) në nxitje të zbatimit të së drejtave dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, e cila përcakton objektiva që duhet të arrihen gjatë periudhës 2004-2014 si edhe përgjegjësitë e qeverisjes qendrore dhe asaj lokale për zbatimin e detyrave të parashtruara në Planin e saj të Veprimit.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), ka luajtur rol thelbësor në nxitjen e hartimit dhe aprovimit të strategjisë. Në rolin e një organizate me fokus nxitjen e

respektimit të të drejtave të individëve me aftësi të kufizuara, me mbështetjen e USAID, Bashkimit Europian dhe Agjencisë për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), FSHDPAK ka shkruar 4 raporte alternative për periudhën 2006, 2007, 2008/2009 dhe 2010. Objektivi i analizës/studimit ishte të vlerësojë progresin e bërë për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit të SKPAK në 5 fushat e saj të ndërhyrjes, jetesë pa barriera, shërbime shoqërore dhe shëndetësore, arsim, formim profesional dhe punësim, krijim kapacitetesh si dhe legjislacion e punë kërkimore, si edhe ndikimin e saj në jetën e personave

me aftësi të kufizuara.

Procesi i monitorimit të ndërmarrë nga FSHDPAK, synon vazhdimin e këtij aktiviteti si domosdoshmëri për nxitjen e zbatimit të SKPAK, nxitjen e procesit të bashkëpunimit ndërsektorial, përfshirë dialogun dhe bashkëpunimin me aktorët e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit për të garantuar politika me pjesmarrje dhe gjithëpërfshirëse. Publikimi i një serie raportesh të tilla, synon të nxisë përgjegjshmerinë e institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe lokal, si edhe transparencën si kritere bazë për garantimin e institucioneve dhe një shteti demokratik.

# Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara, përdorues të karrigeve me rrota në Shqipëri

**F**ondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në kuadër të zbatimit të projektit "Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara, përdorues të karrigeve me rrota", mbështetur nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar USAID, gjatë vitit 2011 ka vazhduar aktivitetin për të përmbushur realizimin e objektivave të këtij projekti të cilat kryesisht konsistojnë në; (1) pajisjen me karrige me rrota të personave me aftësi të kufizuar në nevojë për to, (2) rritjen e shkallës së pavarësisë personale të përdoruesve të karrigeve me rrota si dhe (3) lobimin e vazhdueshëm për të nxitur kryesisht qeverinë dhe institucionet e tjera përgjegjëse në hartimin e një strategjie kombëtare për ofrimin e vazhdueshëm dhe me kosto efektive të karrigeve me rrota për personat me aftësi të kufizuara (PAK) në Shqipëri.

330 karriget me rrota të prodhuara gjatë vitit 2011 në punishten "Mirësia", kanë plotësuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara nga rajone të ndryshme të Shqipërisë si nga; Kavaja, Fieri, Durresi, Berati, Vlora, Shkodra, Kurbini, Tropojë, Dibra, Elbasani, Gramshi, Korça, Kruja, Kukësi, Lezha, Përmeti, Tirana etj. Personat me aftësi të kufizuara të pajisur me karrige me rrota i përkasin grup-moshave të ndry-

shme dhe janë si nga zonat urbane ashtu dhe rurale. Karriget me rrota janë dizenuar dhe prodhuar sipas nevojave individuale të personit me aftësi të kufizuar bazuar në vlerësimin e bërë për këtë qëllim. Krahas karriges me rrota, PAK kanë marrë informacion për kujdes shëndetësor për vehten (PAK janë pajisur me fletë informative për diagnoza të ndryshme të aftësisë së kufizuar) si dhe informacion për përdorimin e karriges me rrota (PAK janë pajisur me manualin e përdorimit të karrigeve me rrota). Personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre u është ofruar informacion për përdorimin dhe mirëmbajtjen e karriges me rrota.

Krahas karrigeve me rrota dhe shërbimeve mbështetëse të lidhura me të, PAK u është ofruar nga stafi i FSHDPAK edhe mbështetje psikosociale, informacion për kuadrin ligjor si dhe në disa raste këshillim ligjor falas nga staf profesionist.

Për të rritur cilësinë e prodhimit të karrigeve me rrota me qëllim që ato në të ardhmen të jenë sa më të përshtatshme për PAK, FSHDPAK gjatë vitit 2011 realizoi një vlerësim të nevojave të PAK për strukturën e karriges me rrota. Për këtë përmes një pyetësori u tërhoq opinioni i 150 personave me aftësi të kufizuara nga rajone të ndryshme të vendit. Rezultatet e këtij raporti ishin të vlefshme për stafin teknik të punishtes "Mirësia" për ti reflektuar në prodhimin e karrigeve me rrota.

Gjatë kësaj periudhe FSHDPAK ka vazhduar gjithashtu përpjekjet për të nxitur qëndrueshmërinë e shërbimit të ofrimit të karrigeve me rrota për PAK në Shqipëri. Lobimi dhe advokacia e FSHDPAK ka patur si qëllim ndikimin në politikat aktuale dhe në reformat ligjore e administrative në vend në linjë me: Strategjinë e Bashkimit Europian për Aftësinë e Kufizuar dhe planin për veprim; Konventën e OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara; ashtu si edhe udhëzuesin e OBSH/USAID/ISPO për sigurimin e karrigeve me rrota në vendet në zhvillim, me qëllim hartimin e një strategjie kombëtare për ofrimin e vazhdueshëm dhe me kosto efektive të karrigeve me rrota për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Pas miratimit të ligjit Për Sigurimin Shëndetësor në Shkurt të 2011, i cili do të hyjë në fuqi pas dy vitesh FSHDPAK gjatë vitit 2011 ka rritur bashkëpunimin me Institutin e Sigurimit Shëndetësor dhe Ministrinë e Shëndetësisë, për të siguruar që aktet nënëligjore të cilat do të hartohen në funksion të tij të marrin në konsideratë rekomandimet dhe propozimet teknike të ofruara nga FSHDPAK për të krijuar mekanizmat e duhura me qëllim sigurimin e karrigeve me rrota dhe shërbimeve mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara në nevojë për to.

# Krijim Kapacitësh për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

**G**jatë vitit 2011, FSHDPAK ka vazhduar zbatimin me sukses të projektit “Krijimi i kapaciteteve për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”. Ky projekt bën pjesë në “Programin Mbështetës për Konventën”, që po zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, PNUD dhe me mbështetjen e PNUD. Gjatë vitit 2011, 738 persona, prej

të cilëve 67% femra (nr 493) përfaqësues të palëve të interesuara për fushën e aftësisë së kufizuar nga Institucionet e qeverisjes në nivel qendror e lokal, shoqëria civile (OJF, biznes dhe media) si edhe ofrues shërbimesh, përfituan njohuri dhe ekspertizë mbi të drejtat e personave me Aftësi të Kufizuara dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përmes 25 seminareve të organizuara në 9

rajone, Elbasan, Vlora, Tirane, Lezhe, Kukës, Gjirokastrë, Korçë, Fier dhe Shkodër.

Po kështu 7 ditë informacioni në 7 universitete dhe 7 debate në mediat lokale i shërbyen ndërgjegjësim-it të mbi 600 studentëve dhe rreth 1/3 së publikut të gjerë në qytetet e lartpërmendura. Projekti do të vazhdojë të zbatohet edhe gjatë vitit 2012, me synim që të mbulojë të 12 rajonet e vendit.

## Punësim për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara

**N**ë muajin Korrik 2011, përfundoi projekti 1 vjeçar i mbështetur nga Fondacioni Vodafone Albania me fokus nxitjen e punësimit për të gjitha kategoritë e njerëzve me aftësi të kufizuara, me synim garantimin sa më të plotë dhe efektiv të të drejtës për jetesë të pavaruar, integrim social dhe pjesëmarrje në komunitet.

Projekti arriti të përmbushë objektivat dhe rezultatet e synuara. Studimi mbi nevojat dhe aftësitë për punë për personat me aftësi të kufizuara, i realizuar gjatë vitit 2010, ndihmoi për të orientuar punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara. Krahas studimit, u krijua një bazë me të dhëna për persona me aftësi të kufizuara punëkërkues të papunë dhe një bazë të dhënash me punëmarrës potencialë në 5 qytetet ku u zbatua projekti Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë dhe Shkodër. 2 fletë informuese, u shpërndanë gjerësisht gjatë zbatimit të projektit tek institucionet përgjegjëse në nivel qendror e lokal, punëmarrës publik e privat, biznese të shumta, OJF të fushës së aftësisë së kufizuar dhe individë me aftësi të kufizuar, në mënyrë të vecantë gjatë realizimit të 5 ditëve informuese. Arritja kryesore e projektit ishte punësimi i 20 individëve me aftësi të kufizuara, një tregues që me gjithë sfidat e shumta arriti të përmbushë. Punësimi i 20 individëve dhe histori të tjera sukcesi të individëve me aftësi të kufizuara u përmbledhën në një botim i cili u promovua në një aktivitet ndërgjegjësuës në Tiranë. Botimi i rasteve të suksesit, materialet mediatike si kronika apo artikuj

në shtyp, dhe komunikimi përmes e-mail etj, përbënë mekanizma të efektshëm për të mobilizuar punëmarrësit dhe agjensitë e punësimit si edhe vetë individët me aftësi të kufizuara mbi mundësitë dhe programet e punësimit për ta.

Me mbështetjen e USAID, FSHDPAK po vazhdon përpjekjet në fushën e punësimit në 3 rrethe, Tiranë, Elbasan dhe Shkodër. Ndërkohë Fondacioni Vodafone Albania po mbështet FSHDPAK për 12 muaj të tjerë, për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në qytetet Durrës, Korçë, Vlorë dhe për të filluar përpjekjet rishtas në qytetin e Fierit.



## Konferenca mbi Zhvillimin Gjithëpërfshirës të Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri: Sfidat dhe Mundësitë drejt Promovimit të Punësimit

Conference on Inclusive Development of Persons with Disability in Albania: Challenges and Opportunities for Promoting Employment



## Projekti "Fuqizim Ekonomik për Personat me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri"

**K**a vazhduar gjatë viti 2011 zbatimi i projektit "Fuqizim Ekonomik për Personat me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri", me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar.

FSHDPAK ka synuar të sjellë sëbashku, përmes një përfaqseje je shume dimensionale, gjithë aktorët përgjegjës për problematikën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara për të siguruar ndërhyrjet e duhura në kuadrin e politikave

dhe legjisacionit, si edhe nxitjen e programeve dhe masave që do të garantojnë fuqizimin ekonomik dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Përmes një procesi të vazhdueshëm avokatie të bazuar mbi punën kërkimore, këshillimin dhe ekspertizën teknike dhe ligjore, FSHDPAK po punon për të nxitur përmirësimin dhe zbatimin e legjisacionit, duke realizuar një raport vëzhgimi, me gjetje dhe rekomandime në lidhje me situatën aktuale

të punësimit të personave me aftësi të kufizuara, i cili u lancua në një konferencë kombëtare.

Gjithashtu FSHDPAK po krijon modele për zhvillimin e karrierës dhe punësimin kryesisht të të rinjëve me aftësi të kufizuara, në mënyrë të veçantë të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara në Tiranë, Elbasan e Shkodër, duke këshilluar e trajnuar deri tani 72 të rinj e të reja punëkërkues me aftësi të kufizuara, (27 femra) dhe duke rregjistruar edhe 43 të tjerë.

## Gjithëpërfshirja e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara

**V**azhdoi dhe u finalizua gjatë vitit 2011 projekti "Promovojmë gjithëpërfshirjen e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara në politika e programe zhvillimi", të mbështetur

nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara, duke vazhduar më tej me fushata ndërgjegjësimi dhe avokati e lobim për përmirësime politikash dhe legjisacioni për të drejtat e grave

me aftësi të kufizuara. Gjatë këtij viti parlamenti shqiptar miratoi strategjinë për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, në të cilën u përfshinë të plota edhe rekomandimet që përgatiti Grupi i Grave Intelektuale me Aftësi të Kufizuara. Gjithashtu u përgatit dhe u promovua raporti i vëzhgimit 'Dhuna ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri'.

# SLID “Integrimit social përmes punës për njerëzit me aftësi të kufizuara”

**S**LID “Integrimit social përmes punës për njerëzit me aftësi të Kufizuara” është një projekt që po zbatohet nga 11 partnerë, në kuadrin e programit IPA -Adriatik - Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar, në vendet e pellgut të Adriatikut, dhe përfshin Kroacinë, Italinë, BiH, Malin e Zi dhe Shqipërinë. Partneriteti i projektit SLID përfshin 3 përfaqësues të qeverive lokale/rajonale, 3 institucione publike, 4 OJF dhe 1 ekspert dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme në mënyrë që të sigurojnë që projekti ndikon efektivisht në nivelet e ndryshme strukturore ndërsektoriale, nga poshtë-lart dhe në krijimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërkufitar. Qëllimi i projektit është të rrisë kapacitetet e vendeve/komuniteteve në zonat e targetuara për t’iu përgjigjur nevojave të personave me aftësi të kufizuara dhe krijimin e shtigjeve të qëndrueshme të rrjetit

të bashkëpunimit për integrim social përmes punës si një koncept novator për ndërhyrje që SLID do të ofrojë për shqyrtim për transferim dhe për replikim më të gjerë në pellgun e Adriatikut.

FSHDPAK është partneri nga Shqipëria, dhe është duke udhëhequr komponentin 4 (SLID-WP4) të projektit – Fuqizimi ndërkufitar i palëve të interesuara në territoret e synuara nga programi.

WP 4 ka për qëllim të lejojë partnerët e SLID, të gjitha palët e interesuara dhe përfituesit final për

të promovuar dhe zbatuar mundësi të barabarta dhe jo-diskriminuese përmes identifikimit të aktorëve kyç, zhvillimit të rrjeteve të reja ndërkufitare të mbështetjes së përbashkët dhe bashkëpunimit, përforcimin e rrjeteve ekzistuese dhe zhvillimin e një baze të përbashkët të dhënash ndërkufitare për territoret ku po zbatohet projekti. Për sa më sipër, WP4 pritet të prodhojë një ndikim të dyfishtë: një ‘busull’ në procesin e integritit social përmes punës (cilët janë aktorët, çfarë mund dhe nuk mund të bëjnë, ku janë ata, se si ata punojnë, etj) dhe një manual me udhëzime për krijimin e rrjeteve dhe “vendndodhjen” në kuadër të procesit të integritit social përmes punës. Baza e të dhënave të palëve të interesuara dhe rrjeteve do të vihen në dispozicion në internet.

**Qëllimi i projektit është të rrisë kapacitetet e vendeve në zonat e targetuara për t’iu përgjigjur nevojave të personave me aftësi të kufizuara dhe krijimin e shtigjeve të qëndrueshme të rrjetit të bashkëpunimit për integrim social**

## Koalicioni Shqiptar Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi / KSHAKZH

**G**jatë vitit 2011, anëtarët e KSHAKZH kanë vazhduar të shkëmbejnë informacion mes tyre, në lidhje me problematika shqetësuese për personat me aftësi të kufizuara. Në Janar u zhvillua një takim i hapur i KSHAKZH, ku anëtarë të koalicionit dhe organizata të aftësisë së kufizuar diskutuan me ekspertin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në lidhje me rekomandi-

met e paraqitura për draft ligjin për arsimin parauniversitar. Një tjetër takim u zhvillua i KSHAKZH u zhvillua në dhjetor, ku anëtarët u njohën me Strategjinë Europiane për aftësinë e kufizuar, rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në mbështetje të qeverisë shqiptare për ratifikimin dhe zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si edhe me iniciativa të fundit të Qe-

verisë Shqiptare për shmangjen e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara, me vëmendje të veçantë ndaj personave me aftësi të kufizuara mendore e të dëgjimit, përmes prezantimeve dhe bashkëbisedimit me të ftuarit, përfaqësuesja e Delegacionit të Bashkimit Europian, përfaqësuesja e PNUD dhe përfaqësuesja e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta.



## Asistencë Ligjore për personat me aftësi të kufizuar

**E**dhe në vitin 2011, Programi Ligjor pranë Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar me mbështetjen e Civil Rights Defenders vazhdoi aktivitetet e tij. Përmes përfaqësuesve në Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë dhe Vlorë, projekti ka ndihmuar mbi 900 persona me aftësi të kufizuar përmes dhënies së asistencës ligjore falas dhe përfaqësimit në gjykatë të personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tyre. Gjatë viteve të zbatimit të këtij projekti, është konstatuar që problematika e aftësisë së kufizuar, në dimensionin e saj social, psikologjik dhe ligjor akoma nuk njihet në nivelet e duhura, sidomos nëqoftëse i referohemi zonave rurale, megjithëse edhe në qytete të mëdha aftësia e kufizuar vazhdon të mbetet një problem individual apo familjar i personave me aftësi të kufizuar dhe jo social.

Duke qënë se të drejtat e personave me aftësi të kufizuar vazhdojnë të mbeten të neglizhuara nga ana e institucioneve dhe mbarë shoqërisë

dhe nga ana tjetër vetë personat me aftësi të kufizuar apo familjarët e tyre vazhdojnë të diskriminohen, të jetojnë në kushte varfërie dhe kanë humbur besimin në institucione, programi ka ofruar vazhdimisht informacion të domosdoshëm për fuqizimin e këtij komuniteti dhe ka lobuar pranë institucioneve të ndryshme, qendrore dhe lokale për njohjen dhe zbatimin më të mirë të legjislacionit ekzistues shqiptar dhe dokumentave ndërkombëtarë.

Gjatë vitit 2011, juristët janë përballur me një sërë rastesh të cilat përfaqësojnë shpeshherë problematikën më të mprehtë të personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tyre. Përmes identifikimit të problematikës, stafi ka arritur të ngrejë në institucione apo përmes deklaratave të ndryshme çështjet më të rëndësishme që prekin të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Mungesa e theksuar e shërbimeve, mohimi i së drejtës për përfitime apo kujdestarisë, çështje të lidhura me strehim, arsimin dhe punësimin kanë qënë fushat krye-

sore të ndërhyrjes edhe gjatë këtij viti. Asistenca ligjore vazhdon të jetë një domosdoshmëri në kushtet që ndodhen personat me aftësi të kufizuar, diskriminim dhe marginalizim. Edhe pse tashmë Shqipëria ka një ligj për ndhmën juridike, ai akoma nuk është funksional. Programi duke synuar jo vetëm dhënien e informacionit apo gjetjen e zgjidhjeve momentale të problemeve të ndryshme, ka pasur në fokus dhe përmirësimet ligjore apo përmirësimet në zbatimin e ligjeve ekzistuese. Kështu, kemi dhënë mendime për aktet nënligjore të Ligjit për Ndhmën Juridike, duke nxjerrë në pah personat me aftësi të kufizuara si një nga grupet përfituese, janë dhënë opinionet ligjore mbi draft-ligjin gjithëpërfshirës të aftësisë së kufizuar, që synon reforma në fushën e aftësisë së kufizuar dhe një sërë ligjesh të tjera, të lidhura drejtëpërdrejtë ose tërthortë me realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Në kuadër të këtij projekti për vitin 2011 janë realizuar seminare ndërgjegjësuese dhe informuese me përfaqësues të gjykatave të të gjitha niveleve mbi aksesin e personave me aftësi të kufizuara dhe konkretisht përshtatshmërinë e ambienteve dhe shërbimeve në gjykata.

**N**ë muajt Shtator- Dhjetor 2011 u zbatua projekti “Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” nga Fondacioni Shqiptar

## **Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**



për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar me mbështetjen e Civil Rights Defenders. Ky projekt synoi njohjen e personave me aftësi të kufizuar me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Projekti u zbatua në Tiranë, Durës, Vlorë, Elbasan, Shkodër, Korçë dhe Fier. Duke qënë se ky ligj është një ligj ri dhe përbën risi

në legjislacionin shqiptar, ai nuk njihet nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, sidomos në qytete të tjera.

Grupe pjesëmarrësisht prej 15 personash u njohën me ligjin, me koncepte të diskriminimit, me format e shfaqjes së tij, më zyrën dhe kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe

procedurat që ndiqen para kësaj zyre. Në realizimin e këtij projekti u bashkëpunua dhe me Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku stafi ishte pjesë e trajnimit të pjesëmarrësve.

Ky projekt u prit me interes nga pjesëmarrësit në seminare, duke qënë se akoma nuk njihet sa duhet nga komuniteti i personave me

## **Zbatimi i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, përpjekje për realizimin e të drejtave dhe barazisë së mundësive për personat me aftësi të kufizuara**

**M**e mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara filloi zbatimin e projektit “Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

përpjekje për realizimin e të drejtave dhe barazisë së mundësive për personat me aftësi të kufizuara”

Ky projekt synon zbutjen e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuar dhe realizimin e të drejtave të tyre në baza të barabarta përmes rritjes së njohurive të personave me

aftësi të kufizuara, organizatave legjitime dhe aktorëve të institucioneve kryesore përgjegjëse dhe përmes propozimeve për akte mbështetëse të ligjit me qëllim zbatimin efektiv të neneve të veçanta, duke vënë theksin mbi konceptin e ‘përshtatjes së





## Pjesëmarrje në trajnim për këshillues dhe zbatimi i ciklit të këshillimit

**F**ondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara që prej Tetorit 2010 ka bashkëpunuar me organizatën Swiss Contact në komponentin e përfshirjes sociale në kuadër të programit ALBVET. Në sajë të ndihmës së tyre, katër këshillues të trajnuar janë punësuar për të lehtësuar punësimin e disa të rinjve me aftësi të kufizuara në qytetet Tiranë dhe Elbasan. Këta të rinj janë trajnuar çdo javë duke bërë takime në grup dhe individualisht. Ata kanë ndjekur kurse të formimit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të tyre. Kurset për mësimin e gjuhës së huaj, për mësimin e kompjuterit dhe për estetikë kanë qenë më të parapëlqyerat. Një tjetër aspekt i rëndësishëm kanë qenë stazhet afatshkurtra dhe afatgjata që disa prej këtyre të rinjve kanë ndjekur në OJF të ndryshme me fokus çështjet sociale. Deri tani një vajzë e re me kufizime në lëvizje ka arritur të vetëpunësohet. Me ndihmën e ALBVET dhe tonën, ajo ka arritur të hapë një minibiznes, një salon të vogël për dizejmim thonjsh. Në kuadër të këtij projekti, tani organizata jonë ka përfiturar një aset të rëndësishëm, katër këshillues të trajnuar nga ekspertë shumë profesionist të cilët janë specializuar si të menaxhojnë dhe të lehtësojnë punësimin për persona me aftësi të kufizuara.

**"atje mësuam se te cilido i-e re me aftësi të kufizuara mund të gjejmë një potencial dhe se cilido prej tyre mund të ushtrojë një profesion". Ky trainim i organizuar nga programi ALBVET injektoi te sfafi ynë një frymë të re e cila u për-coll te përfituesit dhe menjëherë ne mundëm të ndjenim rezultatet pozitive.**

aftësi të kufizuar, i cili nuk është i ndërgjegjësuar në nivelet e duhura mbi atë çka përbën diskriminim dhe si mund të denoncohen raste diskriminimi. Ky projekt është vetëm fillimi i punës që FSHDPAK synon të vazhdojë në të ardhmen me rritjen dhe zgjerimin e njohurive të të gjitha grupeve të interesit të prekura nga ky ligj.

arsyeshme", si një koncept i ri që ka nevojë për sqarime.

Gjatë zbatimit të këtij projekti, janë parashikuar disa trajnime dhe seminare me qëllim ndërgjegjësimin dhe rritjen e kapaciteteve të aktorëve përgjegjës dhe njëkohësisht disa materiale studimore që do t'i shërbejnë sqarimit e saktësimin të disa dispozitave të ligjit, me qëllim zbatimin e tij sa më të mirë nga ana e të gjitha institucioneve të përfshira.

Këta këshillues kryen gjithashtu një trainim shumë të efektshëm në Zvicër në muajin Nëntor të vitit 2011 në universitetin e Luzernë-s. Prej atje mësuam një qasje të re se si të nxisin punësimin social dhe punësimin në tregun e hapur. Vetë këshilluesit u shprehën:

"atje mësuam se te cilido i-e re me aftësi të kufizuara mund të gjejmë një potencial dhe se cilido prej tyre mund të ushtrojë një profesion". Ky trainim i organizuar nga programi ALBVET injektoi te sfafi ynë një frymë të re e cila u për-coll te përfituesit dhe menjëherë ne mundëm të ndjenim rezultatet pozitive.

Revistë e mbështetur nga: Civil Rights Defenders

## ÇFARE ESHTË FSHDPAK

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, FSHDPAK është organizatë jofitimprurëse që prej vitit 1994, fillimisht si program i Oxfam-it për aftësinë e kufizuar në Shqipëri, dhe regjistruar prej vitit 1996 si një OJF e pavarur. Filozofia e FSHDPAK mbështetet në modelin social të aftësisë së kufizuar. Misioni i FSHDPAK është promovim i shanseve të barabarta dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, me fokus të drejtat e personave me aftësi të kufizuar duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës për ta dhe familjet e tyre.

### STRATEGJIA

Për realizimin e misionit të tij FSHDPAK punon ngushtësisht me individë me aftësi të kufizuar dhe shoqata të tyre, shoqata që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe aktore të tjerë të shoqërisë civile, të institucioneve shtetërore e private, përmes zgjerimit e fuqizimit të partneriteteve, duke synuar në zhvillimin e fuqizimin e procesit të avokatisë e vet-avokatisë nëpërmjet informacionit, trajnimeve, ekspertizës ligjore e teknike dhe shërbimeve të tjera.

### Programet e FSHDPAK ofrojnë

- Informacion në fushën e aftësisë së kufizuar
- Trajnim, Konsulencë dhe Ekspertize teknike
- Avokati dhe lobim me synim përmirësimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e aftësisë së kufizuar
- Asistencë ligjore dhe avokat falas për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre
- Prodhim dhe shpërndarje të karrigeve me rrota( e vetmja e këtij lloji në Shqipëri
- Kampe të Rehabilitimit Aktiv për përdoruesit e karrigeve me rrota
- Punësim për njerëzit me aftësi të kufizuar
- Realizim i fushatave ndërgjegjëse përmes medias.

## SFIDA 33

### BASHKËPUNËTORE

Blerta Çani  
Bardhylka Kospiri  
Narbis Ballhysa  
Florida Kalemi  
Anisa Proda  
Sidita Fortuzi

### DESIGN AND LAYOUT

Orest Muça

### ADRESA

Rruga "Bogdani" (ish-A.Z.Çajupi) nr. 15,  
kat i 3, Tiranë Shqipëri.

**Tel:** +355 4 269426

**E-mail:** [adrf@albmail.com](mailto:adrf@albmail.com)

[www.adrf.org.al](http://www.adrf.org.al)